

Vendimi Zviceran cilësohet i paligjshëm për ndalimin e dhënies së pensioneve për Kosovarët



Prishtinë 19 tetor 2011 - Vendimi i Qeverisë së Zvicrës për ndërprerjen e Marrëveshjes mbi Sigurimet Shoqërore Zvicër-Kosovë u shpall i paligjshëm. Lidhur me këtë vendim, për Marrëveshjen mbi Sigurimet Shoqërore Zvicër-Kosovë, Gjyqi Federal i Zvicrës e ka shpallur të paligjshëm vendimin e Qeverisë, që e mori në prill të vitit 2010, me zbatim retroaktiv, nga dita kur është ndërprerë.

U cilësua i paligjshëm vendimi i Qeverisë Zvicerane për ndalimin e dhënies së pensioneve për kosovarët që nuk jetojnë në Zvicër. Madje, gjykata kërkoi që ato të paguhen në mënyrë retroaktive. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) i gëzohet këtij lajmi, ngase përpjekjet e tyre në bashkëpunim me Sindikatën UNIA me Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale dhe ambasadorin e Kosovës në Zvicër, kanë punuar paseshtur për këtë çështje duke kërkuar nga autoritetet zvicerane që të vazhdojnë marrëveshjen për sigurime sociale dhe njëherit së bashku me sindikatën "UNIA", dhe me organizatat tjera patën grumbulluar disa mijëra nënshkrime për një peticion të cilin ua kanë dorëzuar të dy qeverive në muajin maj 2010.

Qeveria zvicerane në dhjetor të vitit 2009, kishte marrë vendim për ndërprerjen e pagimit të pensioneve në Kosovë, duke filluar nga 1 prilli 2010. Në këtë mënyrë, ajo ishte përcaktuar për mos vazhdimin e marrëveshjes mbi sigurimet shoqërore me ish-Jugosllavinë në raport me Kosovën.

Kjo marrëveshje ishte nënshkruar në kohën e ish- Jugosllavisë dhe Qeveria e Zvicrës ndërpret marrëveshjen bilaterale për sigurimet sociale me Kosovën. Marrëveshja përfshinte: pensionin e pleqërisë, sigurimin invalidor, sigurimin në raste fatkeqësie, sëmundje profesionale si dhe shtesat familjare.

Këto sigurime mund t'i gëzonin vetëm personat që mbesin të jetojnë në Zvicër, ndërsa nëse kthehen në Kosovë, e humbin të drejtën për pension.